URDHËR
Nr. 292, datë 4.5.2020

PËR MËNYRËN E VETËKARANTINIMIT TË PERSONAVE QË RIATDHESOHEN

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të nenit 7, pika 1, germa c, të ligjit nr. 15/2016, "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", me qëllim parandalimin e përhapjes së COVID-19 në Republikën e Shqipërisë dhe mbrojtjen e shëndetit të popullatës,

URDHËROJ:

1. Të gjithë shtetasit shqiptar që riatdhesohen në Republikën e Shqipërisë gjatë periudhës së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19 dhe janë me banim në një nga "zonat e kuqe", mund të vetëkarantinohen në ambientet e shtëpisë për një periudhë 14-ditore.
2. Të gjithë shtetasit shqiptar që riatdhesohen në Republikën e Shqipërisë gjatë periudhës së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19 dhe janë me banim në një nga "zonat e gjelbërta", do të karantinohen për një periudhë 14-ditore në ambientet e një strukture akomoduese, sipas përcaktimeve të bëra me vendimin nr. 311, datë 16.4.2020, të Këshillit të Ministrave "Për mënyrën e organizimit të akomodimit të përkohshëm të personave që riatdhesohen si rezultat i gjendjes së shkaktuar nga COVID-19", të ndryshuar.
3. Mosrespektimi i detyrimit të përcaktuar në këtë urdhër, për vetëkarantinim për 14 ditë të personave që riatdhesohen, është i dënueshëm sipas legjislacionit në fuqi.
4. Inspektorati Shtetëror Shëndetësor mbikëqyr zbatimin e urdhrit dhe vendos masën e gjobës, sipas legjislacionit në fuqi.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu